



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5 DHJETOR 2024, ora 19:30**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. DECEMBRA 2024. GODINE, 19:30 časova**

**DHJETOR - DECEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare XXI, “Prishtina 2030”,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-328 për shërbimet e pagesave,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-334 o XXI mediteranskih igrama “Priština 2030”,
2. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-333 o izmeni i dopuni zakona br. 05/L-096 o spriječavanju pranja novea i borbe protiv finansiranja terorizma,
3. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-328 o platim uslugama,
4. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-300 o državnoj maturi.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

A po fillojmë, kolegë? A jeni gati? Po fillojmë. I kemi këtu 4 projektligje, të cilat u argumentuan prej grupit parlamentar që janë të rëndësishme, dhe nëse nuk kalojnë brenda këtij afati kohor, rrezikohen shumë procese të rëndësishme në Republikën e Kosovës. Kështu që, jemi te:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare XXI, “Prishtina 2030”

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim e ka shqyrtuar projektligjin. Neve na e ka rekomanduar ta miratojmë.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, por të cilat janë të përballueshme, kurse amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Zoti Gola, në votim, a po? Projektligji nuk ka amendamente, kështu që e hedhim në votim. Kur të jeni gati, më tregoni!

Projektligji për Lojërat Mesdhetare, shqyrtimi i dytë i projektligjit. Bëhuni gati për votim. Votojmë tash!

63 vota për, 0 kundër, 0 abstenime. Kuvendi e miratoi Ligjin për Lojërat Mesdhetare, “Prishtina 2030”.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislativën e BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetar i komisionit, çka thotë për këtë projektligj? I mirë, a! Armend Muja është aty.

ARMEND MUJA: Kryetar, e kemi miratuar si komision dhe u bëjmë thirrje deputetëve ta votojnë.

KRYETARI: E hedhim në votim. Nuk paska fare amendamente, kështu që e votojmë në lexim të dytë. Bëheni gati për votim. Votojmë tash!

63 vota për, kundër asnjë, abstenime asnjë. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-328 për shërbimet e pagesave

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin dhe na e ka rekomanduar edhe neve për ta miratuar.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk rregullohen në mënyrë specifike prej legjislativës së BE-së, kurse Komisioni për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Zoti Muja, kryetar i komisionit, e ka fjalën.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar,

Komisioni e ka trajtuar, e ka votuar dhe ju bën thirrje edhe juve si deputetë ta miratoni. Faleminderit!

KRYETARI: Përgatituni për votim! Është shqyrtimi i dytë i projektligjit. Bëhuni gati për votim. E votojmë tash këtë projektligj.

62 vota për, 0 kundër, 0 abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për shërbimin e pagesave.

Të nderuar kolegë deputetë,
E kemi tash pikën e radhës, e cila është:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore

Komisioni për Arsim e ka shqyrtuar projektligjin dhe na e ka rekomanduar që ta miratojmë.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, por ato janë të përballueshme për buxhetin tonë, kurse amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime të tilla. Projektligji me amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën.

Komisioni për Integritet Evropian thotë që projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetari i komisionit, z. Gola!

ARDIAN GOLA: Po kryetar, ashtu sikur e thatë. Të mos e përsëris për hir të efektivizimit të kohës. Përndryshe, e kemi vetëm një amendament të propozuar nga Enis Kervan, kuptohet, përkrahjet edhe nga Komisioni Funkcional. Vetëm të lutem vazhdo tutje me procedurë.

KRYETARI: Zoti Kervan, është mbështetur nga komisioni, apo jo? E hedhim në votim amendamentin. Pajtoheni? Mirë! Ma bën me shenjë që nuk dëshiron. Vazhdojmë! A doni të flisni, zoti Kervan? Mirë! Prezentojeni amendamentin.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti në fjalë është lidhur me paragrafin 1 të nenit 5 të ligjit, i cili riformulohet, si në vijim: “Kandidati apo kandidatja i nënshtrohet provimit të maturës në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, ose në njërën nga gjuhët zyrtare në nivel komunal në Republikën e Kosovës”. Prandaj, e kërkoj përkrahjen nga deputetët!

Çocuklarımızın ana dilinde sınava girmesi için tabi tutulması için desteklerinizi bekliyoruz. Faleminderit!

KRYETARI: Ky ishte amendamenti i zotit Kervan. E ka përkrahjen e Komisionit Funkcional. E hedhim në votim këtë amendament. 63 vota për, 0 kundër, 0 abstenime. Kuvendi e miratoi amendamentin e vetëm që e patëm.

Tash e hedh projektligjin në votim, bashkë është me këtë amendament që sapo e miratuam. E votojmë Projektligjin për provimin e maturës shtetërore. Votojmë tash!

62 vota për, 0 kundër, 0 abstenime. Konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin për provimin e maturës shtetërore. Dhe, me këto 4 pika që i patëm, konstatoj që u mbyll kjo seancë. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*